

Dr. Dhonat Kote, i datëlindjes 30.08.1983, është aktualisht pedagog i Informatikës dhe prej vitit 2014 edhe në funksionin e Drejtorit të Filialit të Universitetit të Tiranës në Sarandë. I diplomuar në Universitetin “Maqedonia” të Selanikut, Greqi, Departamenti i Informatikës së Aplikuar, ai është angazhuar në mësimdhënien e sistemeve kompjuterike në Universitete të ndryshme. Me marrjen e gradës Doktor i Shkencave në Informatikë, ka zhvilluar studime kërkimore lidhur me rëndësinë e teknologjisë dhe përdorimit të saj në fushën e bujqësisë në Shqipëri, si një element i qënësishëm për zhvillimin ekonomik dhe modernizimin e fermave të rajonit. Ka punuar në projekte me bizneset lokale dhe pushtetin vendor për promovimin e zhvillimit përmes teknologjisë dhe për zhvillimin e programeve kompjuterike për zbatime të ndryshme ekonomike dhe menaxheriale. Botimet e tij më të fundit trajtojnë “Rritjen e efikasitetit të fermave përmes përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, “Krijimin e qëndrueshmërisë së fermave përmes përdorimit të sistemeve të informacionit dhe komunikimit”, si dhe “Internetin e gjërave dhe aplikacionet elektronike në bujqësi (e-farming)”. Ka njohuri shumë të mira të gjuhës greke dhe angleze dhe është angazhuar në projekte të shumta për promovimin e Filialit të Sarandës në rajon dhe më gjerë.